**VENDIM**
**Nr. 578, datë 13.10.2017**

# PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 512, DATË 13.7.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës IV, të vendimit nr. 512, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika IV/1, me këtë përmbajtje:

"IV/1. Deri në miratimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, në bazë të të cilit do të përcaktohet organi që ngarkohet me përgjegjësinë e administrimit të ujërave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të vazhdojë të ushtrojë kompetencat në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të ujërave.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**